



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:118429
Datë: 07.06.2024
Numri i dokumentit: 05793143

K.DH.Shk II.nr. 903/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P.T “Edona”, me NUI: 810683145, me seli në Vushtrri, rr. “Dëshmorët e Kombit”, kundër debitorit Andi Group, Sh.p.k NUI: 811291046, me seli në Gjilan, rr. “Abdullah Tahiri”, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Fadil Sinanaj nga Gjilani, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.2361/22 të datës 30.10.2023, me datë 07.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Andi Group, Sh.p.k., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së parë, KPPP.nr. 2361/22 të datës 30.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 2361/22 të datës 30.10.2023, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimi i debitorit Andi Group, Sh.p.k, me seli në Prishtinë, ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 324/22, i lejuar me datë 03.10.2022, nga Përmbartuesi Privat Sheremet H. Livoreka dhe Urdhri Përmbartimor P.nr. 324/22, i lejuar me datë 03.10.2022, nga Përmbartuesi Privat Sheremet H. Livoreka mbetet në fuqi

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmabrimore, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 2361/22 të datës 30.10.2023,

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.P.T “Edona”, ka paraqitur propozim për përmbarim P.nr. 324/22, i lejuar me datë 03.10.2022 me të cilin ka lejuar përmbarimin, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; faturë nr. 1-8/3528-2022 e datës 16.03.2022, faturë nr. 1- 83330-2022 e datës 16.03.2022, faturë nr. 1-8/3512-2022 e datës 16.03.2022, faturë nr. 1- 8/3526-2022 e datës 16.03.2022. faturë nr. 1-8/3814-2022 e datës 22.03.2022, faturë nr. 1- 8/3840-2022 e datës 22.03.2022, faturë nr. 1-8/3869-2022 e datës 23.03.2022, faturë nr. 1- 8/3835-2022 e datës 23.03.2022. faturë nr. 1-8/3836-2028 e datës 23.03.2022. faturë nr. 1- 8/3837-2022 e datës 23.03.2022, faturë nr. 1-8/3838-2022 e datës 23.03.2022, faturë nr. 1- 8/5106-2022 e datës 13.04.2022, faturë nr. 1-8/5108-2022 e datës 13.04.2022, faturë nr. 1- 8/5471-2022 e datës 20.04.2022 faturë nr. 1-8/11905-2022 e datës 17.08.2022, faturë nr. 1- 8/11906-2022 e datës 17.08.2022, faturë nr. 1-8/11908-2022 e datës 17.08.2022, faturë nr. 1- 8/11910-2022 e datës 17.08.2022. faturë nr. 1-8/12262-2022 e datës 23.08.2022, faturë nr. 8/12261-2022 e datës 23.08.2022, faturë nr. 1-8/12332-2022 e datës 24.08.2022, faturë nr. 1- 8/12333-2022 e datës 24.08.2022, faturë nr. 1-8/12400-2022 e datës 25.08.2022, faturë nr. 1- 14/780-2022 e datës 11.05.2022, faturë nr.1-14/374-2022 e datës 21.03.2022, faturë nr. 1- 14/564-2022 e datës 14.04.2022, faturë nr. 1-21/699-2022 e datës 11.05.2022, faturë nr. 1- 21/686-2022 e datës 19.05.2022, faturë nr. 1-21/1214-2022 e datës 24.08.2022, faturë nr. 1- 21/1 177-2022 e datës 01.09.2022, me të cilën është detyruar debitori që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave

të lartcekura, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 7,019.32€ si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore. Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes të cilit ka kundërshtuar Urdhrin Përmbartimor me arsyetimin se faturat nuk janë në rregull sa i përket borxhit e po ashtu obligimi nuk është real pasi që debitori ka bërë pagesa të vazhdueshme i njëjti ka komunikuar me kreditorin dhe ka kërkuar nga ai të bëjë barazimin e kartelave analitike dhe pasi të barazojnë blerjet, kthimin e mallit dhe pagesat atëherë do të dihet borxhi i saktë i debitorit dhe atë borxh debitorit do ta paguaj brenda afatit ligjor. Po ashtu ka shtuar se kreditori e ka heshtur faktin se nga këto fatura të paraqitura në propozim është dashur që 3% të shumës të zbritet nga secila faturë për shkak se kjo është paraparë në Kontratën për Furnizim. I ka propozuar gjykatës që të aprovet në tërësi prapësimi i debitorit, si dhe të shfuqizohet urdhri përmbartimor P.nr.324/22 i datës 03.10.2022 si dhe të obligohet kreditori që debitorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës. Kreditori në përgjigjen ndaj prapësimin, ka theksuar se urdhri përmbartimor është bazuar në dokumente të besueshme në përputhje me dispozitat e LPP-së ndërsa borxhi i cili është kërkuar në propozim është në bazë të barazimit të kartelës financiare. Ka shtuar se qëllimi i vetëm i prapësimin është shtyrja dhe prolongimi i pagesës që ka ndaj kreditorit sepse pretendimet në prapësim nuk janë bazuar në asnjë provë konkrete. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit si i pa bazuar ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr.324/22 i datës 03.10.2022 të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë duke vendosur lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit të dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, andaj u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për arsyet si në vijim: 3 Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Tutje Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat vlerëson se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbartimor P.nr. 324/22 i datës 03.10.2022 i përmbajnë të gjitha tiparet e

dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje shkalla e parë ka vlerësuar pretendimet e debitorit se faturat e lartcekura nuk përbëjnë dokumente të besueshme ngase nuk përmbajnë nënshkrimin e personit të autorizuar si dhe vulën e debitorit, por gjeti se të njëjtat janë të pa bazuara, për shkak se në bazë të provave që gjenden në shkresa të lëndës, secilës faturë i është bashkangjitur dëshmia mbi pranimin e mallit e lëshuar nga vet debitori me rastin e dorëzimit të faturës dhe mallit nga kreditori, dhe të cila dëshmi përmbajnë nënshkrimin dhe vulën e debitorit dhe përmbajnë përshkrimin dhe sasinë e njëjtë të produkteve sikurse në faturat objekt i këtij përbarimi. Për më tepër, pranimi i faturave mbi bazën e të cilave është lejuar përbarimi vërtetohet edhe nga vet kartela financiare e debitorit e ofruar me rastin e paraqitjes së prapësimit, ku evidentohen pranimi i mallit dhe faturave për të cilat kërkohet përbarimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, shkalla e parë lidhur me këtë çështje përbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe shkalla e dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Tutje dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit Gjykata Komeriale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhoma e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumentin e besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se faturat me nr. 1-8/3528-2022 e datës 16.03.2022, faturë nr. 1- 83330-2022 e datës 16.03.2022, faturë nr. 1-8/3512-2022 e datës 16.03.2022, faturë nr. 1- 8/3526-2022 e datës 16.03.2022. faturë nr. 1-8/3814-2022 e datës 22.03.2022, faturë nr. 1- 8/3840-2022 e datës 22.03.2022, faturë nr. 1-8/3869-2022 e datës 23.03.2022, faturë nr. 1- 8/3835-2022 e datës 23.03.2022. faturë nr. 1-8/3836-2028 e datës 23.03.2022. faturë nr. 1- 8/3837-2022 e datës 23.03.2022, faturë nr. 1-8/3838-2022 e datës 23.03.2022, faturë nr. 1- 8/5106-2022 e datës 13.04.2022, faturë nr. 1-8/5108-2022 e datës 13.04.2022, faturë nr. 1- 8/5471-2022 e datës 20.04.2022 faturë nr. 1-8/11905-2022 e datës 17.08.2022, faturë nr. 1- 8/11906-2022 e datës 17.08.2022, faturë nr. 1-8/11908-2022 e datës 17.08.2022, faturë nr. 1- 8/11910-2022 e datës 17.08.2022. faturë nr. 1-8/12262-2022 e datës 23.08.2022, faturë nr. 8/12261-2022 e datës 23.08.2022, faturë nr. 1-8/12332-2022 e datës 24.08.2022, faturë nr. 1- 8/12333-2022 e datës 24.08.2022, faturë nr. 1-8/12400-2022 e datës 25.08.2022, faturë nr. 1- 14/780-2022 e datës 11.05.2022, faturë nr.1-14/374-2022 e datës 21.03.2022, faturë nr. 1- 14/564-2022 e datës 14.04.2022, faturë nr. 1-21/699-2022 e datës 11.05.2022, faturë nr. 1- 21/686-2022 e datës 19.05.2022, faturë nr. 1-21/1214-2022 e datës 24.08.2022, faturë nr. 1- 21/1 177-2022 e datës 01.09.2022, e përmbajnë nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbartueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Së këndejmi, Gjykata thekson se me plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm mund ta ketë fuqinë e titullit përmbartues sepse rezulton se debitori e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbartimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që

procedura përbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Një veprim i tillë, për Gjykatën paraqet pranimit të faturës dhe detyrimit.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përbarimore organi përbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimit e ligjshmërisë së përbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç' rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K. DH.Shk II.nr. 903/24 me datë 07.06.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti